



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK**

PROÇESVERBAL

Nr. 8, datë 28.04.2022

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin prill, që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:05

Data e mbajtjes së mbledhjes : 28.04.2022

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Kryetarja e Bashkisë znj. Emiriana Sako dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar Këshilltarë ! E nderuar Kryetare !

Të nderuar të pranishëm !

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës për muajin prill të Këshillit Bashkiak Durrës.

Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga Kryetarja e Bashkisë, me të cilin jeni vënë në dijeni në bazë të dokumentacionit që ju është vënë në dispozicion në postën elektronike nga Sekretaria e Këshillit.

Ftoj Sekretaren e Këshillit të bëj prezencën në sallë.

Dorina Milja: Përshëndetje! Fillojmë.

Jolanda Mustafaraj ... prezent...ok.....deri tek.... Morena Boja....mungon.....

Kryetar ke 35 këshilltarë në sallë.

(p.s. Hyri me vonesë dhe votoi R.Koti pika 2 e vazhdim dhe F.Mërkuri në pikën 4 e vazhdim të R.D).

Ani Dyrmishi : Faleminderit !

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojme leximin e pikave që shtrohen sot për rend dite. Sot kemi për miratim 7 pika, të cilat unë po vazhdoj t'i lexoj një e nga një.

1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6 % DHE FONDI NGA TË ARDHURAT E BASHKISË, PËR MUAJIN PRILL 2022
2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE MENAXHIMIN E ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2022
3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË RINDËRTIMIT TË PËRFITUAR NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 167, DATË 18.03.2022 “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË DURRËS, VORË, KAMZË DHE RROGOZHINË”
4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË VKB-NË NR.162, DATË 23.12.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PROFESIONAL DHE KONVIKTEVE TË SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE “BEQIR ÇELA” DHE SHKOLLËS SË MESME TEKNOLOGJIKE “HYSEN ÇELA”, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE DHE PAGESAVE PËR VITIN SHKOLLOR 2021-2022”
5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT NË VKB-NË NR.163, DATË 23.12.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR SI DHE KONVIKTIT TË SHKOLLËS SË MESME SPORTIVE “BENARDINA QERAXHIA”, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE DHE PAGESAVE PËR VITIN SHKOLLOR 2021-2022” TË NDRYSHUAR
6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.158, DATË 23.12.2021 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2022 SI DHE PROJEKTBUXHETIN AFATMESËM TË BASHKISË DURRËS 2022-2024”
7. Shtesë	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TOTAL PREJ 10,033,344

Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	LEKË PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I TERRENTIT SPORTIV NË SHKOLLËN 9 VJEÇARE “FSHAT RINIA”, NJËSIA ADMINISTRATIVE KATUND I RI, DURRËS, SI NJË KONTRIBUT I PËRBASHKËT MIDIS BASHKISË DURRËS DHE WORLD VISION ALBANIA
Pyetje dhe diskutime	DISKUTIME DHE PYETJE

Për rendine ditës kemi ndonjë koment nga ana këshilltarëve?...

Atëherë s’kemi, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 35 vota pro miratohet rendi i ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit **numër 1**, i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjimore dhe Mirëqënies Sociale, këshilltares znj. Klementina Meçi.

Klementina Meçi: Faleminderit Kryetar! Përshëndetje të gjithëve!

Komisioni Barazisë Gjimore dhe Mirëqënies Sociale mori në shqyrtim pikën e parë të rendit të ditës dhe shqyrtoi gjithë dokumentacionet e vëna në dispozicion nga bashkia e Durrësit dhe vendosi konkretisht miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike për 89 familje dhe miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi 6% i fondit kushtëzuar për 25 familje.

Nga sa më sipër komisioni vendosi me unanimitet kalimin e kësaj pike për votim në Këshillin Bashkiak. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 1, kemi nga ana e këshilltarëve? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 35 vota pro miratohet dhe pika 1 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit të **pikës 2 të R.D**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike me kryetare znj. Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Faleminderit Kryetar! Përshëndetje !

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike pasi mori në shqyrtim pikën 2, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë z. Afrim Bakaj

Afrim Bakaj : Edhe Komisioni i Mbrojtjes Civile, Emergjencave Civile është në unanimitet dhe voton pro kësaj pike.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Atëherë përsa i përket pikës 2 të rendit të ditës, kemi komente nga ana e këshilltarëve? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Dorina Milja : Kryetar ke 36 këshilltarë, pasi hyri Roberta Koti.

Ani Dyrmishi : Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet pika 2 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit të **pikës 3**, i japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Elio Jani.

Elio Jani : Faleminderit Kryetar.

Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me pikën 3 të rendit të ditës dhe propozon miratimin e saj. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit z. Jani.

Komisioni i Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave z. Indrit Cërloj.

Indrit Cërloj : Përshëndetje Kryetar !

Për pikën 3 Komisioni u mbledh dhe me unanimitet miratoi pikën 3 të rendit të ditës.

Ani Dyrmishi : Faleminderit z. Cërloj.

Përsa i përket pikës 3, kemi komente nga ana e këshilltarëve? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 3 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 4**, i japim fjalën Komisionit të Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, znj.Jolanda Mustafaraj.

Jolanda Mustafaraj : Përshëndetje!

Komisioni u mbledh dhe mori vendim unanimitet që kjo pikë të kalojë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit

Komente përsa i përket pikës 4, kemi nga ana e këshilltarëve? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?

Dorina Milja : Kryetar ke 37 këshilltarë, pasi hyri Fatmir Mërkuri.

Ani Dyrmishi : Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet pika 4 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 5**, i japim fjalën Komisionit të Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, znj.Jolanda Mustafaraj.

Jolanda Mustafaraj : Edhe për këtë pikë Komisioni ra dakort që të kaloj.

Ani Dyrmishi : Faleminderit

Komente përsa i përket pikës 5, ka nga ana e këshilltarëve? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet dhe pika 5 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 6**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave z. Indrit Cërloj.

Indrit Cërloj : Edhe për pikën 6 të rendit të ditës Komisioni u mblodh dhe votoi pro kësaj pike.

Ani Dyrmishi : Faleminderit z. Cërloj.

Përsa i përket pikës 6, kemi komente nga ana e këshilltarëve? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 6 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet dhe pika 6 e rendit ditës.

- Kalojmë në **pikën 7**, i japim fjalën Komisionit të Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, znj.Jolanda Mustafaraj.

Jolanda Mustafaraj : Edhe për këtë pikë njësoj si dy pikat e para Komisioni ra dakort që të kaloj.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave z. Indrit Cërloj.

Indrit Cërloj : Edhe për këtë pikë Komisioni ra dakort që kjo pikë të kaloj.

Ani Dyrmishi : Atëherë për pikën 7, ka ndonjë koment nga ana e këshilltarëve? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 7 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet dhe pika 7 e rendit ditës.

- Meqë rendi i ditës përfundoi ka kërkuar **fjalën për diskutim** këshilltarja Etleva Velçani dhe përgatitet Flutura Kasa.

Etleva Velçani : Përshëndetje Kryetare! Përshëndetje Kryetar!

Përshëndetje të nderuar Këshilltarë !

Në diskutim me disa nga tregtarët, të cilët punojnë në tregun industrial, agro - industrial, agro - ushqimor me fal, ngrejnë shqetësimin se pas rikonstruksionit të tregut, normal që ka dhe devijime gjatë projektit, por është spostuar, hyrja e tregut është spostuar çik më tutje. Mbas mbylljes së hyrjes të cilët këto e pretendojnë që kanë qënë aty, thonë që ka rënë puna dhe po falimentojnë.

Të lutem nëse gjehet një gjuhë e përbashkët, ndoshta një përfaqësues i bashkisë të konsultohet me këto tregtarët dhe të gjejnë një zgjidhje të mundshme. Faleminderit!

Emiriana Sako : Në dijenin time për projektin, qëllimi ka qënë rikonstruksioni i projektit dhe kryesisht puna është fokusuar tek rikostruksioni, pra ndrimi i pllakave, kanalizimi ujrave të bardha, ndrimi i mbulesës të markatës dhe vëndet kanë qënë po të njëjtat. Madje “Ne” kemi pasur takime të vazhdueshme me shitësit aty dhe derisa u vendosën siç donin ato të gjithë banaqet, në mënyrë që mos kishin asnjë ndryshim nga proçesi i punës që bënin më herët. Edhe sot markata funksionon me 3 hyrje. Pra, hyrja nga rruga kryesore, hyrja nga pjesa e brëndshme e pallateve dhe pjesa tjetër që të çon tek shkolla. Kështu që nuk kemi bërë ndryshime madhore përsa i takon strukturës në vetvete. Dhe sigurisht nëse bëhet fjalë pastaj për shitës, që janë në pjesën private të markatës ai është një subjekt që operon në bazë të kushteve të veta domethënë dhe nuk kemi patur shqetësime të kësaj natyre.

Etleva Velçani : Jo, bëhet fjalë për pjesën nga rruga kryesore.

Emiriana Sako : Hyrja është po aty ku ka qënë. Pra, ato hyn nga rruga kryesore, mund të ketë një spostim një, dy metër, por kjo nuk është argument për të thënë që po falimentoj, sepse dera është po aty ku është dhe subjektet kanë ruajtur të njëjtët pozicion në markat siç kanë qënë më herët.

Meqenëse u ngrit dhe ky shqetësim për markatën doja të sqaroja dhe diçka tjetër opinionin. “Ne” kemi arsye pse është bërë me dy faza blerja e banaqeve, ka qënë sepse pati një ndryshim të çmimit të hekurit gjatë kohës që “Ne” e kishim në proçes në tenderimin e vlerës së banaqeve.

Dhe për herë të parë në garën e parë nuk pati pjesmarrje nga firma për të zbatuar këtë projekt, pikërisht për këtë arsye “Ne” u detyruam të bënim një buxhet tjetër dhe e ndamë në 2 faza mobilimin e markatës, dhe parashikojmë që pjesa e dytë, pra ajo që nuk është ende funksionale me banaqe të reja do të bëhet brënda një muaji si të thuash, sepse është në proces prokurimi. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit Kryetare !

Znj. Flutura Kasa.

Flutura Kasa : Faleminderit Kryetar !

Kisha 2 pyetje shkurt.

Për përfituesit DS5, që kanë marrë përsipër të bëjnë ndërtimet me fondet e bashkisë, a ka mundësi që të bëjnë dhe shëmbjet e shtëpive me të ardhurat e veta që mos të presin deri kur t’i vi radha? T’i jepet nga bashkia një leje përshembull. Kjo është pyetja e parë. Ta bëj dhe të dytën.

Dhe pyetja e dytë është për përfituesit e DS4-ës, që janë për rforcim. Nëse mundet, meqenëse është dhe volum i madh pune a mund të bëhet dhe për këto si DS5-sa që gjithkush të bëj vet rforcimet? Faleminderit.

Emiriana Sako : Subjektet të cilët kanë marrë miratimin nga Këshilli Bashkiak dhe nga Qeveria Shqiptare për ta financuar vet objektin e tyre, pjesë të procesit kanë dhe shëmbjen patjetër, sepse dhe “Ne” kur kemi bërë pjesën e parë të likuidimit në pjesën e dytë do të duhet që të demonstrohet që objekti i vjetër nuk ekziston, sepse përbën rrezik. Përveç atyre që thamë për lejen e ndërtimit, për shëmbjen e objektit të vjetër ka një praktikë shumë të thjeshtë, që është si leja e ndërtimit ashtu dhe leja e prishjes jepet nga Kryetari i Bashkisë duhet të bëjnë një aplikim në sistem me 2, 3 dokumenta ku përfshihet akti i konstatimit ose ekspertiza që objekti duhet shëmbur dhe një demonstrim i një dokumenti pronësie apo posedimi dhe me këto dokumenta japim lejen e shëmbjes me të cilën mund të vazhdoj më tej me praktikën e çregjistrimit nga hipoteka të banesave. Kjo sa për pyetjen e parë .

Përsa i takon pyetjes së dytë : A mund të kaloj DS4 në grant kesh? Jo, sepse DS4 ka një proces shumë kompleks të zbatimit të objekteve dhe “Ne” nuk kemi garancinë që qytetarët do të arrijnë të zbatojnë projektet ashtu siç janë financuar nga Qeveria Shqiptare. Dhe për të qenë të sigurtë për këtë kemi përzgjedhur që të zgjedhim studio të licensuara, të cilat do ta bëjnë këtë punë, përsa i takon subjekteve përfituese, pra këtyre qytetarëve. Edhe fondet janë relativisht më të larta në krahasim dhe me ndërtimin e banesave individuale. Në zbatim ka kompleksitet të lartë, se nuk flasim vetëm për banesat që janë 1 katë apo 2 katë, por ka objekte me familjar, që kanë lartësi 3 ose 4 kate. Pra, për banorët nuk kemi garanci se do t’i ndërtojnë ashtu siç duhet, prandaj për këtë arsye kemi kërkuar fond për riparimin e tyre, fond për mbikqyrësin dhe fond për kolaudimin. Pra, do të jetë një proces sipas legjislacionit në fuqi. Faleminderit.

Flutura Kasa : Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Atëherë faleminderit Kryetare !

Ju faleminderit të gjithëve pjesmarrësve, Kryetares, përfaqësuesve të medias, të gjithëve.
Mbledhjen e deklaroj të mbyllur dhe për mbledhjen e radhës do t'ju njoftojmë me rrugë elektronike me anë të Sekretarisë së Këshillit.
Ju faleminderit.

Ky procesverbal mbyllet me nr.rendor 8(tetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset sipas Rregullores së Funkcionimit të KB nga Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit.

Mbajtësi i procesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :	ANI DYRMISHI
Sekretare e Këshillit Bashkiak :	DORINA MILJA
Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :	ELIO JANI
Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :	ETLEVA VELÇANI